



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 57 Prot

Tiranë, më 29.04, 2013

**VENDIM Nr. 253, datë 29.04.2013**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 29.04.2013, pasi shqyrtoi "Raportin e plotësuar të sondazheve arkeologjike të kryer në sheshin e ndërtimit me adresë: **Lagjja "Ajazëm"**, zona arkeologjike "B", Shkodër, paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik mbi bazën e kërkesës së KKA,

**VENDOSI:**

- I. Miratimin e raportit përfundimtar të sondazhit arkeologjik, të përgatitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Shkodër për sheshin e ndërtimit në pronësi të **Familjes Dabërdaku**, Lagjja "Ajazëm", Shkodër.
- II. Të lejojë fillimin e punimeve në sheshin e ndërtimit "Godinë shërbimi 1 kat", zona arkeologjike "B", **Shkodër**, në pronësi të **Familjes Dabërdaku**.
- III. Të realizohet mbikëqyrja arkeologjike deri në përfundim të procesit të gërmimit të themeleve, bazuar në kontratën dypalëshe midis **Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik** dhe subjektit zbatues të punimeve.  
Mbikëqyrja arkeologjike do të kryhet nga specialistë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Shkodër deri në arritjen e kuotës së gërmimit të parashikuar në projekt.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**VISAR ZHITI**

**MINISTËR**

**SEKRETAR I KKA**

**ROLAND OLLI**

